

Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|--|--|
| Njësia akademike: | Fakulteti ekonomik i UP |
| Titulli i lëndës: | Kontabiliteti i menaxhmentit 2 |
| Niveli: | Msc |
| Statusi lëndës: | Obligative / zgjedhore |
| Viti i studimeve: | 2 |
| Numri i orëve në javë: | 2+1 |
| Vlera në kredi - ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | Semestri i shtatë |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.asoc.dr. Skender Ahmeti |
| Detajet kontaktuese: | E-mail: skender.ahmeti@uni-pr.edu |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Kontabiliteti i menaxhmentit 2 është lënda e dytë në listën e lëndëve që ofrohen nga fusha e kontabilitetit që i dedikohet shfrytëzuesve të brendshëm të kompanisë. Kjo lëndë është për studentët e studimeve master. Lënda është e orientuar në njohjen tuaj me raportet e brendshme më të avancuara që i përgatit kontabiliteti për nevoja të menaxhmentit. |
| Qëllimet e lëndës | Kontabiliteti i menaxhmentit 2 është i dedikuar për përgatitjen e informatave të nevojshme për menaxhmentin. Qëllimi i lëndës konsiston në njohjen e veglave të kontabilitetit të menaxhmentit që përdoren në raste të ndryshme të vendim marrjes. Ekzistenca e kontabilitetit të menaxhmentit është domethënëse për shkak të rolit të saj në marrjen e vendimeve afariste dhe zgjidhjen e shumë pa-qartësive afariste. Gjithsesi kuptimi themelor i kontabilitetit është ndihma në marrjen e vendimeve por në rastin e Kontabilitetit të menaxhmentit theksi është në marrjen e vendimeve të brendshme. Materialet janë të aplikueshme jo vetëm për biznesin por edhe për situata tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e informatave të efikasitetit dhe efektivitetit. |
| Rezultatet e pritura të nxënies | <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptoni llojet kryesore të kostove, • Të kuptoni metodat e kalkulimit të kostove indirekte, • Të kuptoni metodat e kalkulimit të kostove për prodhimin për porosi, • Të kuptoni metodat e kalkulimit të kostove për prodhimin serik, • Të kuptoni metodat e kalkulimit sipas ABC-së |

| | | | |
|---|---|------------------|-----------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptoni decentralizimin dhe kontabilitetin e përgjegjësishë në procesin e marrjes së vendimeve • Të kuptoni procesin e buxhetimit. • Të kuptoni matjen e shmangieve të kostove standarde • Të kuptoni procesin e buxhetimit kapital • Të kuptoni analizën e pasqyrve financiare dhe treguesve financiar | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokviume | 2 | 3 | 6 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 3 | 6 | 18 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 4 | 4 | 16 |
| Totali | | | 145 |
| Metodologjia e mësimdhënies | <p>Përcjellja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është esenciale. Studentët të cilët janë të rregullt kanë sukses ndërsa ata të cilët nuk shkojnë rregullisht në orë kanë probleme.</p> <p>Leximi i rregullt i kapitujve të përcaktuar më parë. Mësimi i kontabilitetit të menaxhmentit është i vazhdueshëm, kuptimi i koncepteve të reja është ngushtë i lidhur me mësimin e koncepteve nga kapitujt paraprak.</p> <p>Mundohuni të zhvilloni kuptimin e koncepteve. Mos tentoni të mbani në mend materialet. Në të shumtën e rasteve mbajtja mend nuk do të ndihmojë në studimin tuaj. Në kontabilitetin e menaxhmentit 2 detyrat në të shumtën e rasteve kërkojnë të aplikoni konceptet e mbuluara më herët dhe të mendoni për materialet e prezantuara më herët. Këto detyra nuk mund të kryhen pa i trajtuar në esencë problemet dhe pa menduar mirë. Kjo na jep të kuptojmë se nuk duhet të ngutemi në fillimin e kryerjes së detyrës në formën teknike për detyra të caktuara. Duhet të kaloni pak kohë duke konsideruar mësimet e mbuluara në klasë dhe kërkesat lidhur me detyrat specifike.</p> | | |

| | |
|---|--|
| Metodat e vlerësimit | Shkallët e notave: Ne do të shfrytëzojmë këtë shkallë të notimit për studentët e rregullt |
| | 91-100% - nota 10 (dhjetë) |
| | 81-90% - nota 9 (nëntë) |
| | 71-80% - nota 8 (tetë) |
| | 61-70% - nota 7 (shtatë) |
| | 51-60% - nota 6 (gjashtë) |
| 50-me pak - nota 5 (pesë) | |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | 1. Prof.asoc.dr. Skender Ahmeti: "Kontabiliteti i menaxhmentit" Prishtinë, 2013. 2. Hansen&Mowen:"Menaxhimi i kostos"- botim i përkthyer, 2009 |
| Literatura shtesë: | 1. Wild & Shaw:"Managerial accounting", 2010 Edition, McGraw - Hill/Irwin, New York. 2. Noreen, Brewer, Garrison:"Managerial accounting for managers"Ed.2, McGraw - Hill, 2011. |
| Plani i dizajnuar i mësimit | |
| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
| <i>Java e parë:</i> | Përshkrimi (prezantimi) i lëndës |
| <i>Java e dytë:</i> | Kontabiliteti i menaxhmentit dhe koncepti i kostove |
| <i>Java e tretë:</i> | Kalkulimi i kostos për prodhimin sipas porosisë |
| <i>Java e katërt:</i> | Kalkulimi i kostos së proceseve (metoda FIFO) |
| <i>Java e pestë:</i> | Kalkulimi i kostos së proceseve (mesatarja së ponderuar) |
| <i>Java e gjashtë:</i> | ABC metoda |
| <i>Java e shtatë:</i> | Alokimi i kostove të departamenteve të lidhura |
| <i>Java e tetë:</i> | Alokimi i kostove të departamenteve të lidhura (vazhdim) |
| <i>Java e nëntë:</i> | Alokimi i kostove të departamenteve mbështetëse |
| <i>Java e dhjetë:</i> | Planifikimi i profitit - master buxheti |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i> | Planifikimi i profitit - master buxheti (vazhdim) |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i> | Buxhetimi fleksibël dhe përlllogaritja standarde |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i> | Kontabiliteti i përgjegjesisë |
| <i>Java e katërmëdhjetë:</i> | Çmimet transfer në kompanitë e decentralizuara |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | Analiza e investimeve kapitale |
| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: | |
| Kopjimi dhe transmetimi i fjalëve nuk lejohet në këtë lëndë. Nëse studentët takohen në këto aktivitete, ata do të trajtohen në bazë të rregulloreve përkatëse të Universitetit të Prishtinës. Me këtë rast do të merr notën e dobët dhe ky aktivitet do të përcillet në shënimet personale të studentit. | |